

Data: 06.02.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Rikonstruksion i zyrave të AAPSK”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45210000-2 Punime ndërtimi

Vlera e fondit limit: 8,530,327.02 (tetë milion e pesëqind e tridhjetë mijë e treqind e njëzetë e shtatë pikë zero dy) lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 3 (tre) muaj

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet (2022, 2023, 2024) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo më vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës. *(Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.)*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :

40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit, bazuar në pikën 4, të nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vitit të kërkuar për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: ” *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratës të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se, operatori ekonomik fitues, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara, për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;
 - Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.

- 1.1 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.
- 1.2 Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **20%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa, vlera limit e kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$8,530,327.02 \times 30\% = 2,559,098 \text{ leke}$$

Gjithashtu referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: *“Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (a dhe b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku qartazi përcaktohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285,

datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku percaktohet se: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave a dhe b të pikës 1, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jepen të paplotesuara sipas standartit.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **NP-3A** Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-4A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- **NS-12A** Impiante teknologjike ,termike dhe te kondicionimit.
- **NS-14A** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), si dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP -3A	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash.	Heqje tavan i varur me kartonxhes Suvatim shpatullash ne rikonstruksion Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe Patinim tavani me stuko Patinim muri me stuko Veshje me pllake majolike Veshje tavani me kartonxhes Heqje vetrate duralumini ekzistuese Heqje dyer ekzistuese F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e I-re. Heqje pllaka dyshemeje Shtrese llaç-çimento t=8cm Shtrese parketi laminat Shtrese me pllaka grez porcelanato Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa Boje hidroplastike cilesi e larte FV vetrate ne fasade FV vetrata per ndarje te brendshme etj.	A (0- 20 milionë lekë)
NS -4A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.	Suvatim shpatullash ne rikonstruksion Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe Patinim tavani me stuko Patinim muri me stuko Veshje me pllake majolike Veshje tavani me kartonxhes	

		F.V. Dyer te brendeshme druri cilesi e I-re. Shtrese parketi laminat Shtrese me pllaka grez porcelanato Boje hidroplastike cilesi e larte FV vetrare ne fasade FV vetrata per ndarje te brendshme etj.	
NS -12A	Impiante teknologjike ,termike dhe te kondicionimit.	Vendosje Njesi e jashtme VRF tip Pompe nxehtesie 12HP Vendosje Njesi e brendshme tip kasete, e pajisur me ventilator inverter sipas ST Vendosje Njesi e brendshme tip murale, e pajisur me ventilator inverter dhe valvol ekspansioni sipas ST Vendosje Njesi ventilimi me rekuperim energjie Vendosje Panel kontrolli individual per cdo pajisje te brendshme kondicionimi. Tipi per montim ne mur dhe lexim temperature ne panel. Vendosje Panel kontrolli individual per secilin rekuperator nxehtesie ajri F.V. Damper volumi ajri d.100 F.V. Damper volumi ajri d.125 F.V. Damper volumi ajri d.200 F.V. Difuzor rrethor, prej materjal alumini. I lyer me boje (RAL do percaktohet nga arkitekti). Diam. 100 F.V. Difuzor rrethor, prej materjal alumini. I lyer me boje (RAL do percaktohet nga arkitekti). Diam. 125 F.V. Difuzor rrethor, prej materjal alumini. I lyer me boje (RAL do percaktohet nga arkitekti). Diam. 200 F.V. Grile 4 kendore, prej materjal alumini. E lyer me boje (RAL do percaktohet nga arkitekti). Dim. 400x200 F.V. Grile 4 kendore me 2 rreshta, prej materjal alumini. E lyer me boje (RAL do percaktohet nga arkitekti). Dim. 400x200 F.V. Grile 4 kendore me 2 rreshta, prej materjal alumini. E lyer me boje (RAL do percaktohet nga arkitekti). Dim. 400x300 F.V. Plenum / reduksion llamarine e termoizoluar per gryken e dergimit dhe thithjes se pajisjeve F.V. Plenum / kuti llamarine e termoizoluar per grilat e ajrit	

		F.V. Shuares zhurme L=1m per kanal ajri 300x250 dhe prurje 1000m³ F.V. Linja gazi prej materjal bakri i termoizoluar i pershtatshem per linja frigoriferike, i prodhuar sipas st fi 6.35 mmx 0.8 mm F.V. Linja gazi prej materjal bakri i termoizoluar i pershtatshem per linja frigoriferike, i prodhuar sipas st fi 12.70 mm x 0.8 mm F.V. Linja gazi prej materjal bakri i termoizoluar i pershtatshem per linja frigoriferike, i prodhuar sipas st fi 28.58 mmx 1.0 mm F.V Tuba e rakorderi PP ose PPR d=20~32~40mm per shkarkimin e kondensatit F.V Sifon per drenazhin e kondensatit tip HL-138 F.V. Kabell Komunikimi i skermuar F.V. Gaz frigoriferik R410A F.V. KIT kolektor gazi frigoriferik me 8 porta origjinal me prodhuesin e pajisjeve (dimensione sipas projektit) F.V. Rakorderi bakri per tuba gazi frigoriferik F.V. Konstruksione metalike, antivibrante, fasheta dhe materjale te imta per montimin e pajisjeve te jashtme dhe te brendshme. Njesi e jashtme VRF tip Pompe nxehtesie 12HP, e pajisur me kompresor scroll full inverter qe punon me gaz frigoriferik R-410A, Njesi e brendshme tip kasete, e pajisur me ventilator inverter. Njesi e brendshme tip murale, e pajisur me ventilator inverter dhe valvol ekspansioni. Njesi ventilimi me rekuperim energjie sipas ST Panel kontrolli individual per cdo pajisje te brendshme kondicionimi. Tipi per montim ne mur dhe lexim temperature ne panel. Panel kontrolli individual per secilin rekuperator nxehtesie ajri etj.	
NS -14A	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.	F.V. Priza shuko universal F.V. Kuti suport pllaket 4 mod F.V. Kuti suport pllaket 2 mod F.V. Kanaline metalike 210x65	

		F.V. Tub plastmasi Ø 22-26mm F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm F.V. Tub plastmasi Ø 31-36mm F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm² F.V. Percjelles PV-500 Ø 10 mm² F.V. Percjelles PV-500 Ø 6 mm² F.V. Percjelles PV-500 Ø 4 mm² F.V. Çelesa e priza 10 A F.V. Percjelles PV-500 Ø 1.5 mm² F.V. Percjelles PPV Ø 2x1 mm² F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm Vendosje Panel elektrik sipas Skemes se projektit. F.V. Kanaline plastike 80x60 mm e kompletuar me te gjithë aksesoret e montimit poshte tavolinave si vida upa etj F.V. Modul per fiksim suporti ne kanaline plastike 100x60 F.V. Kutu ne kanaline metalike 100x100 e kompletuar me te gjithë aksesoret e montimit si vida upa etje F.V. Fuqia 30W/m, Ndricimi lumens 3800 lm, Frekuenca 50 - 60 Hz, Tonaliteti 4000 K, Energy class A+, Safety class 1, IP IP20-40 F.V. Fuqia 25W, Ndricimi lumens 4645 lm, Frekuenca 50 - 60 Hz, Tonaliteti 4000 K, Energy class A+, Safety class 1 IP IP20-40 F.V. Ndricues LED spot inkaso Gipsi sipas ST IP IP20-40 F.V. Ndricues LED spot inkaso Gipsi sipas ST IP IP20-40 F.V. Sensor levizje PIR Montim Rack 32 U 60x80 Cm perfshire terminimin e kablove ne patch panele F.V. Patch panel FTP Cat 6, 24 porta duke perfshire dhe terminin dhe emertimine kabujve FTP Cat 6 F.V. Switch 24 porta F.V. Patch Guide F.V. Power bar 6 - 8 shuko F.V. Bateri ventilatoresh te kopletuar me te gjithë aksesoret si permostat, kontrollor temperature etj F.V. Kabell FTP Cat 6 F.V. Priza FTP CAT 6 RJ 45 F.V. Antena wifi F.V. Tape 1 module	
--	--	--	--

		F.V. Pajisje DVR per sistemin CCTV F.V. Kamera IP outdoor F.V. Ushqyesi F.V. Lexues karte F.V. Modul per lexuesin e kartes F.V. Pajisje kontrolli F.V. Kundra brave F.V. Kabell bus Instalimi dhe konfigurimi F.V. Central konvencional I alarmit te zjarrit me 2 zona F.V. Sensor tymi , nxehtesie konvencional F.V. Sensor tymi brenda tavanit F.V. Pulsant manual per sinjalizim zjarri Vendosje UPS 15kVA, 3IN-1OUT Panel elektrik sipas Skemes se projektit. Rack 32 U 60x80 Cm perfshire terminimin e kablllove ne patch panele, testim kolaudim. Bateri ventilatoresh te kopletuar me te gjithë aksesoret si permostat, kontroller temperature etje UPS 15kVA, 3IN-1OUT etj.	
--	--	--	--

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve, objekt kontrate, duhet të ketë të punësuar minimumi **12** (dymbëdhjetë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per muajin e fundit te deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë

minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratës. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendorsja e kriterit për një punësim të paktën 12 punonjes duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë puntorë që kërkohet për realizimin e punimeve është min 12 punonjes.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknik të shoqërisë

nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitave ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mekanik

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik**

të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik te punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar preventivit të punimeve si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP3,NS4** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Nërtimit**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS12** eshte e nevojshme prezencat **një Inxhinieri Mekanik**
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS14** eshte e nevojshme prezencat **një Inxhinieri Elektrik**

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë) nga organe kompetente si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
Hidraulik	1
Elektricitist	1
Instalues dhe riparues te sistemeve ngrohje-ftohje	1
Suvatues	1
Pllakashtrues	1
Specialist gipsi	1
Punonjes per dyer dritare	1
Bojaxhi	1
Shofer	1

2.3.6/1 Për punonjesin shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë individuale të punës;
- leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale. *(Në rastin kur punonjësit shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga organe kompetente .

Percaktimi i numrit të punonjesve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punes si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport), Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a. Certifikatën e cilësisë së punimeve **SSH DIN EN UNI ISO 9001-2015 e perditesuar** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në bazë të zerave të punimeve që ka marrë persiper të realizojë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI/ISO** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.7 gërma “a” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

SSH DIN EN UNI ISO 9001-2015 e përditësuar (e vlefshme)/ose/ekuivalent, është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.3.8 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 1.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Vinç	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Pompë Suvatimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Depozitë uji min ne 1000 litra	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Matrapik	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Pompë Uji	copë	1	Në pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); c) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Nëpërmjet këtyrë kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qellim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është

përcaktuar duke u bazuar në zerrat e preventivit dhe specifikimeve teknike. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapesirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete të renda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes, Kontratës së Qirasë apo Huapërdorjes. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoritetit Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Janë sipas të dhënave dhe shënimeve teknike në projektin e zbatimit, bashkëlidhur DST-ve, të dërguara pranë organit qëndror blerës nga Autoriteti Kontraktor përfitues.